

AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR  
**InterMedia SHPK.**

**THEMELIMI**

**Neni 1**  
Ortaku themelues

1.1 Shoqëria InterMedia SHPK themelohet nga Ortaket

**Z.Edmir Cjapi** , shtetas shqiptar Lindur me 04/02/1980 ne Fier , banues ne Rruga Jeronim De Rada Lagja 2, Tirane ,mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. I00204053B.

**Z. Anastas Pandili**, shtetas shqiptar, lindur më 17.09.1993, ne Veria GRC,, banues Nazmi Frakulla, Njësia Administrative Nr. 1 Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. J30917029D.

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2**  
Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është **InterMedia sh.p.k**

**Neni 3**  
Forma ligjore

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.



**Neni 4**  
Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

**Neni 5**  
Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është për një afat të papercaktuar.

**Neni 6**  
Selia

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Muhamet Deliu, Komuna Dajt, Nr Pasurie 197 68-N-4, Zona Kadastrale 2460, Tiranë

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim 2/3 të Asamblese së Ortakëve.

**Neni 7**  
Objekti

7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: *Sherbime në lidhje me turizmin, online marketing, Teknologjine e prenotimeve online, programim dhe implementim që lidhet me produkte digitale. Ndermjetesim ndermjet klienteve dhe provider të moduleve teknologjike të prenotimeve online.*

7.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakëve .

## **Neni 8**

### Kapitali

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Leke i ndare ne 100 Kuota
- 8.2 Ortaku Edmir Cjapi zoteron 50 (pesedhjte) kuota, te cilat eshte e barabarte me vleren e kapitalit prej 50.000 Lekesh .  
Ortaku Anastas Pandili zoteron 50 (pesedhjte) kuota, te cilat eshte e barabarte me vleren e kapitalit prej 50.000 Lekesh .
- 8.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

## **Neni 9**

### Transferimi i kuotave. Kufizimet.

- 9.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese duke marrë miratimin paraprak të ortakëve.
- 9.2 Vendojsja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakeve .

## **Neni 10**

### Rritja e kapitalit

- 10.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim unanim të Ortakeve.
- 10.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të unanim te Ortakeve.

## **Neni 11**

### Zvogëlimi i kapitalit

- 11.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 11.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga ortakët e shoqërisë. Eksperti kontabël dhe

administratori do të shqyrtojë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

11.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim unanim të Ortakeve

## **ORGANET E SHOQËRISË**

### **Neni 12**

#### **Vendimet e ortakut të vetëm**

12.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaket me arritjen e një kuote prej 75 % të totalit.

12.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.

### **Neni 13**

#### **Administratoret, Emerimi, Shkarikimi dhe Kompetencat**

13.1 Shoqëria administrohet nga një ose me shumë administratore të emëruar nga asambleja e ortakëve, për një afat jo më të gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërteritje.



13.2 Administratori i shoqërisë është **Z. Edmir Cjapi**, shtetas shqiptar Lindur me 04/02/1980 ne Fier Banues ne Rruga Jeronim De Rada Lagja 2, Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. I00204053B.

13.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakeve.

13.3 Asambleja e ortakeve me 2/3 mund te shkarkoj administratoret ne cdo kohe.

13.4 Asambleja e ortakeve me 2/3 mund te emeroje Administratore te rinj.

13.5 Administratoret kane te drejtat, kompetencat dhe detyren te kryejne veprimet e parashikuara ne Ligjin tregtar dhe ne kete Statut.

13.6 Asambleja e ortakeve mund te miratoje rregulla te brendshme procedurale, te detyrueshme per zbatim nga administratoret, ne lidhje me realizimin e administrimit te Shoqerise, perfshire konsultime me dhe/ose miratime paraprake per veprime te caktuara.

13.7 Perfaqesues i vecante i Asamblese se Ortakeve eshte Z. Anastas Pandili

13.8 Administratori ka Tagrat e perfaqesimit ligjor per te perfaqesuar i vetem Shoqerine, Ne lidhje me te gjitha transaksionet me bankat dhe vendimarjen per projektet e reja, investimet kufizohet permes detyrimit per te kryer transaksionin me nenshkrim te Z. Anastas Pandili, i caktuar si perfaqesues i vecante i Asamblese se Ortakeve

#### **Neni 14**

##### **Perfaqesimi Ligjor**

14.1 Administratoret jane perfaqesuesit ligjor te Shoqerise. ka kompetenca per te perfaqesuar Shoqerine ne marredheniet me palet e treta, perfshire cdo autoritet publik dhe gjyqesor.

14.2 Tagrat e perfaqesuesit ligjor per te perfaqesuar i vetem Shoqerine per disa veprime me pale te treta, mund te kufizohen nepermjet detyrimit per te kryer veprimin me nenshkrim te perbashket me nje prej administratoreve te tjere, apo me nje perfaqesues te posacem te caktuar nga asambleja e ortakeve.

#### **Neni 15**

##### **Asambleja e Ortakeve, te Drejtat e votes**

15.1 Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise, dhe ushtron te drejtat e detyrimet e percaktuara sipas Ligjit Tregtar.

15.2 Asambleja e ortakeve thirret, mban mbledhje dhe miraton vendime te vlefshme ne perputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

15.3 Secila Kuote ka nje numer votash te barabarte me pjesen qe ajo ze ne kapitalin e Shoqerise.

### **Neni 16**

#### Viti financiar

16.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

16.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

### **Neni 17**

#### Bilanci, Kontabiliteti

17.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga ortakët dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

17.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

17.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

### **Neni 18**

#### Te Ardhurat. Dividendi

18.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

18.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t'i kalojnë ortakut të vetem.

18.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulojnë deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakut do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

### **Neni 19** Likuidimi

19.1 Prishja e shoqërisë vendoset mes Asamblese së Ortakeve .

19.2 Me vendimin e Ortakeve caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

19.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, ortakët do të shqyrtojnë bilancin përfundimtar dhe do të miratojnë përfundimin e procedurave të likuidimit.


### **Neni 20** Mosmarrëveshjet

20.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

### **Neni 21** Klauzolë mbyllëse

21.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

**Tiranë, datë 08/18/2020**



Anastas Pandilo

